



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

**KOMISIONI PËR LEGJISLACION, MANDATE, IMUNITETE, RREGULLOREN E
KUVENDIT DHE MBIKËQYRJEN E AGJENCISË KUNDËR KORRUPSIONIT**

P l a n i
I PUNËS PËR VITIN 2016

Prishtinë, 2016

Komisioni për Legjislacion

Plani i punës për vitin 2016

Fushëveprimet e Komisionit

Komisioni për Legjislacion, si Komision i përhershëm, e shqyrton bazën juridike dhe kushtetuese për nxjerrjen e çdo ligji të Kuvendit të Kosovës. Në këtë kontekst, Komisioni në mënyrë të veçantë:

- Analizon dhe vlerëson përshtatshmërinë e akteve, të cilat i miraton Kuvendi i Kosovës, me Kushtetutën;
- Në raste të caktuara, paraqet propozim-ligj, amendament në ligj, ose në aktin të cilin e miraton Kuvendi i Kosovës;
- Shqyrton projektligjet në aspektin e kushtetutshmërisë dhe të ligjshmërisë;
- Shqyrton deklarata politike, rezoluta dhe akte të tjera nënligjore, në miratim nga Kuvendi i Kosovës, nga aspekti i kushtetutshmërisë së tyre;
- Shqyrton çështjet parimore të harmonizimit të legjislacionit me Kushtetutën;
- Shqyrton propozimet për ndryshime kushtetuese;
- I kërkon Qeverisë amendamentin e ligjeve, me qëllim të harmonizimit me legjislacionin e tjetër, në raste të veçanta edhe vetë amendamenton ligje për këtë qëllim.
- Shqyrton çështjet që lidhen me metodologjinë dhe me teknikën unike të hartimit të legjislacionit;
- Shqyrton çështjet e gjyqësisë në Kosovë;
- Mbikëqyrë zbatimin e ligjeve në fushën e gjyqësisë në përgjithësi.
- Shqyrton çështjet e tjera, të përcaktuara me këtë rregullore dhe çështjet të cilat me vendim të veçantë, i barten këtij Komisioni;
- Angazhon ekspertë për çështje të caktuara të fushëveprimit të Komisionit;
- Organizon dëgjime publike për çështje të caktuara në fushën e legjislacionit;
- Formon grupe të punës për shqyrtimin e çështjeve të caktuara të fushëveprimit të Komisionit;
- Ushtron mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve të miratuara nga Kuvendi i Kosovës;
- Komisioni kontakton me komisionet e tjera të Kuvendit, për t'i njoftuar për ushtrimin e mbikëqyrjes së zbatimit të ligjeve të miratuara nga Kuvendi.
- Komisioni bashkëpunon me të gjitha ministrinë, prej të cilave mund të kërkojë të dhëna konkrete nga fushëveprimi i tij.

Objektivat

- Komisioni për legjislacion do të jetë efikas në përmbushjen e rolit mbikëqyrës duke ndihmuar Kuvendin dhe Qeverinë në ndërtimin e një infrastrukture ligjore, e cila është e harmonizuar në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.
- Komisioni për legjislacion do ta ngritë nivelin e monitorimit të punës së zyrtarëve publikë, duke kërkuar në vazhdimësi takime dëgjimore mbi punën e tyre. Po ashtu komisioni në vazhdimësi do të monitorojë institucionet publike duke analizuar zbatimin e politikave publike.
- Komisioni për legjislacion do të rrisë nivelin e bashkëpunimit me qytetarë, grupe të interesit, përfaqësuesit e organizatave ndërkombëtare, si dhe të shoqërisë civile në vend, me qëllim të përmbushjes së rolit të tij si komision i përhershëm.

Anëtarët e Komisionit

ALBULENA HAXHIU – Kryetare,	GP – LVV
SELVIJE HALIMI- Zëvendëskryetare e parë,	GP - PDK
DANUSH ADEMI– Zëvendëskryetar i dytë,	GP - 6+
AGIM ALIU – Anëtar,	GP - PDK
NEZIR ÇOÇAJ – Anëtar,	GP - PDK
ARMEND ZEMAJ – Anëtar,	GP - LDK
AGIM ADEMAJ – Anëtar,	GP - LDK
DONKA KADAJ BUJUPI – Anëtare,	GP - AAK
VALDETE BAJRAMI – Anëtare,	GP - NISMA
DORUNTINË MALOKU – Anëtare,	GP - LDK
MILENA MILIÇEVIÇ – Anëtare.	GP – LS

Aktiviteti i Komisionit për vitin 2016

Muaji	Aktiviteti	Bartësi i aktivitetit	Synimi	Indikatorët
Janar	Mbledhje e Komisionit	Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit	<ol style="list-style-type: none"> 1. Shqyrtimi i çështjeve nga fushëveprimi i Komisionit; 2. Miratimi i raportit të punës së Komisionit për vitin 2015; 3. Procedimi i Projektligjit nr. 05/L-060 për Mjekësinë Ligjore; 	
Shkurt	Mbledhje e Komisionit	Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit	<ol style="list-style-type: none"> 1. Ndërmarrja e veprimeve lidhur me zgjedhjen e drejtorit të AKK-së; 2. Shqyrtimi i projektligjeve me amendamentet e propozuara nga Komisionet funksionale; 3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-049 për administrimin e pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar, 4. Formimi i grupeve punues për monitorimin e ligjit nr. 04/L-050 për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë dhe të ligjit nr. 04/L-141 për provimin e jurisprudencës; 5. Shqyrtimi i Projektligjit për Akademinë e Drejtësisë (Programi Legjislativ); 6. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-087 për Kundërvajtje; 7. Dëgjim publik për Projektligjet për Akademinë e Drejtësisë dhe Projektligjin për Kundërvajtje; 	

Mars	Mbledhje e Komisionit	Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit	<ol style="list-style-type: none"> 1. Shqyrtimi i çështjeve nga fushëveprimi i Komisionit; 2. Shqyrtimi i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 03/L-057 për Ndërmjetësim (Programi Legjislativ); 3. Shqyrtimi i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore (Programi Legjislativ); 4. Dëgjim publik për Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 03/L-057 për Ndërmjetësim dhe për Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore; 5. Shqyrtimi i Projektligjit për Kuvendin; 6. Shqyrtimi i Rregullores së Kuvendit; 7. Takim me ministrin e Drejtësisë lidhur me zbatimin e rekomandimeve të Komisionit për Legjislacion në ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale; 8. Shqyrtimi i Raporteve vjetore të Institucioneve/ Agjencive të pavarura, para Komisionit. 	
Prill	Mbledhje e Komisionit	Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit	<ol style="list-style-type: none"> 1. Shqyrtimi i çështjeve nga fushëveprimi i Komisionit; 2. Shqyrtimi i Projektligjit për Aktet Normative (Programi Legjislativ); 3. Dëgjim publik për Projektligjin për Aktet Normative; 4. Shqyrtimi i projektligjeve me amendamentet e propozuara nga Komisionet funksionale; 5. Takim me institucionet që bien në fushëveprim të Komisionit lidhur me mbikëqyrjen buxhetore 	
Maj	Mbledhje e Komisionit	Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit	<ol style="list-style-type: none"> 1. Shqyrtimi i çështjeve nga fushëveprimi i Komisionit; 2. Shqyrtimi i projektligjeve me amendamentet e propozuara nga Komisionet funksionale; 3. Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 05/L-10 për Agjencinë Kosovare për krahasim dhe verifikim të pronës; 	

Qershor	Mbledhje e Komisionit	Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit	<ol style="list-style-type: none"> 1. Shqyrtimi i çështjeve nga fushëveprimi i Komisionit; 2. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (Programi Legjislativ); 3. Dëgjim publik për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik dhe për Projektligjin për konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme; 4. Shqyrtimi i Projektligjit për konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme (Programi Legjislativ); 	
Korrik	Mbledhje e Komisionit	Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit	<ol style="list-style-type: none"> 1. Shqyrtimi i çështjeve nga fushëveprimi i Komisionit; 2. Shqyrtimi i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 03/L-010 për Noterinë. (Programi Legjislativ); 3. Dëgjim publik për Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 03/L-010 për Noterinë. 	
Gusht	Pushim vjetor	Pushim vjetor	Pushim vjetor	Pushim vjetor
Shtator	Mbledhje e Komisionit	Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit	<ol style="list-style-type: none"> 1. Shqyrtimi i çështjeve nga fushëveprimi i Komisionit; 2. Formimi i grupit punues për monitorimin e ligjeve nr. 03/L-224 për këshillin prokurorial të Kosovës dhe të ligjit nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës; 3. Shqyrtimi i Projektligjit për Institutin për Hulumtimin e Krimeve të Luftës. (Programi Legjislativ); 4. Shqyrtimi i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Kodit të drejtësisë për të mitur (Programi Legjislativ); 5. Dëgjim publik për Projektligjin për Institutin për Hulumtimin e Krimeve të Luftës; 	

Tetor	Mbledhje e Komisionit	Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit	<ol style="list-style-type: none"> 1. Shqyrtimi i çështjeve nga fushëveprimi i Komisionit; 2. Shqyrtimi i projektligjeve me amendamentet e propozuara nga Komisionet funksionale; 	
Nëntor	Mbledhje e Komisionit	Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit	<ol style="list-style-type: none"> 1. Shqyrtimi i çështjeve nga fushëveprimi i Komisionit; 2. Shqyrtimi i Projektligjit për Zyrën e Prokurorit Disiplinor (Programi Legjislativ); 3. Shqyrtimi i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 02/L-40 për Provimin e Jurisprudencës (Programi Legjislativ); 4. Dëgjim publik për Projektligjin për Zyrën e Prokurorit Disiplinor dhe për Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 02/L-40 për Provimin e Jurisprudencës; 5. Shqyrtimi i projektligjeve me amendamentet e propozuara nga Komisionet funksionale; 	
Dhjetor	Mbledhje e Komisionit	Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit	<ol style="list-style-type: none"> 1. Shqyrtimi i çështjeve nga fushëveprimi i Komisionit; 2. Shqyrtimi i projektligjeve me amendamentet e propozuara nga Komisionet funksionale; 3. Shqyrtimi i Projektligjit për të drejtën Ndërkombëtare Private (Programi Legjislativ); 4. Dëgjim publik për Projektligjin për të drejtën Ndërkombëtare Private; 	

Nënkryetarja e Komisionit

Selvije Halimi